



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	360
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	26.07.2023
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Nr: 01/360/2023

Datë: 25.07.2023

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1) dhe nenit 11 (paragrafi 4) të Ligjit Nr. 05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2023, merr këtë:

**VENDIM**

- I. Miratohet Rregullorja Nr. 03/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vatën Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë  
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**

*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

Në bazë të nenit 10 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e datës 25.07.2023, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë miraton këtë:

**RREGULLORE**

**(AD) NR.03/2023**

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.04/2017 PËR  
PUNËN E KËSHILLIT PROGRAMOR TË AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores nr.04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregullore janë të zbatueshme për anëtarët e Këshillit, zyrtarët që janë prezent gjatë mbledhjeve të Këshillit, organet e Akademisë, si dhe secilin subjekt tjetër me të cilin ndërlihet puna e Këshillit.

**Neni 3**

Pas nenit 5 të rregullores bazike, shtohet neni i ri 5A, me përmbajtjen si në vijim:

**Neni 5 A**

**Kompetencat e Këshillit Programor lidhur me trajnuesit dhe mentorët**

1. Kompetencat e Këshillit Programor lidhur me trajnuesit dhe mentorët, në pajtim me rregulloren përkatëse për trajnues dhe mentor, janë si në vijim:

1.1. jep mendim për listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për trajnues sipas nenit 9 paragrafit 8 dhe 9 të rregullores përkatëse për trajnues dhe mentor;

1.2. jep mendim për angazhimin e trajnuesve sipas nenit 9a të rregullores përkatëse për trajnues dhe mentor;

1.3. jep propozim Këshillit Drejtues për vlerësimin e trajnuesve dhe mentorëve, sipas nenit 16 të rregullores përkatëse për trajnues dhe mentor;

1.4. jep mendim Bordit Drejtues për propozimin për largimin e trajnuesit nga lista e trajnuesve, sipas nenit 17 të rregullores përkatëse për trajnues dhe mentor.

#### **Neni 4**

Pas nenit 6 të rregullores bazike, shtohet neni i ri 6A, me përmbajtjen si në vijim:

#### **Neni 6 A**

##### **Emërimi i anëtarëve të Këshillit Programor**

1. Këshilli Drejtues e hap procedurën publike për emërimin e anëtarit ose anëtarëve të rinj, së paku dy (2) muaj para përfundimit të pritshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit Programor, ose me përfundimin e parakohshëm të detyrës së tij/saj.
2. Njoftimi publikohet në ueb faqen e Akademisë, në ueb-faqet e KGJK-së dhe KPK-së, si dhe u dërgohet gjykatave, prokurorive dhe institucioneve të tjera.
3. Kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët, drejtuesit e institucioneve të tjera mund të propozojnë kandidatë brenda afatit prej dy javësh nga dita e publikimit. Kandidatët kanë të drejtë që të aplikojnë edhe personalisht sipas publikimit.
4. Kandidatët për anëtar të Këshillit Programor, duhet të posedojnë:
  - 4.1. Kompetencë të dëshmuar në një fushë të caktuar të së drejtës ose në sistem të drejtësisë;
  - 4.2. Pesë (5) vite përvojë profesionale në sistemin e drejtësisë;
  - 4.3. Njohuri dhe përvojë në fushën e trajnimit gjyqësor.
5. Nominimi ose aplikimi mund të bëhet përmes postës, me email ose përmes paraqitjes së aplikimit në Akademi. Nominimit/aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet një CV dhe dokumentet përkatëse që dëshmojnë përmbushjen e kërkesave sipas paragrafit 4 të këtij neni. Përmbajtja e formularit të nominimit/aplikimit miratohet nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.
6. Drejtori Ekzekutiv ia paraqet Këshillit Drejtues nominimet dhe aplikimet e pranuar.
7. Këshilli Drejtues emëron anëtarin ose anëtarët e Këshillit Programor, duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e profesioneve, të fushave të sistemit të drejtësisë si dhe njohurive gjuhësore të kandidatëve.
8. Anëtarët e rinj të Këshillit Programor e marrin detyrën pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të vjetër.

## Neni 5

Tek neni 8 i rregullores bazike, shtohet paragrafi 2 me përmbajtjen si në vijim:

2. Anëtarët e Këshillit Programor gjatë mandatit të tyre nuk angazhohen si trajnues të përkohshëm.

## Neni 6

Tek neni 11 i rregullores bazike, paragrafi 2 riformulohet me përmbajtjen si në vijim:

2. Njoftimi për mbledhjen dërgohet me postë elektronike (e-mail) ose me shkresën e dorëzuar përmes zyrës së Drejtorit, të paktën pesë (5) ditë pune para mbledhjes. Përfundimisht, në raste urgjente, mbledhja mund të thirret në afate më të shkurtra.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Akademia e Drejtësisë



Prishtinë, 25/07/2023